TRI RASTE TË STUDIMIT NË PROKURIM PUBLIK NGA FUSHA E EDUKIMIT

KEQMENAXHIMI, LËSHIMET DHE MËSIMET E NXJERRA

Rasti I: Renovimi i shkollave të mesme dhe fillore

Tenderi për renovim të shkollave të mesme dhe fillore në Komunën e Shtërpcës u publikua më 18 shtator 2020, me vlerë të parashikuar prej 267,272 euro dhe me afat prej tre muajsh për të përfunduar punët. Në këtë tender ofertoi vetëm një konsorcium, Euro Infrastruktura & NSH Besa me çmim 264,125.90 euro, e cila edhe fitoi kontratën. Vlera e kontratës është sa 98.8% e vlerës së parashikuar. Komuna përmes kërkesave në dosje të tenderit në mënyrë të hapur ka krijuar kushte që tenderin ta fitojë vetëm konsorciumi i mësipërm.

Lëshimet

- Kërkesa për certifikata të panevojshme.
- Shkurtimi i kohës për të dorëzuar ofertat.
- Përshtatja e kritereve për vetëm një ofertues.

Në dosje të tenderit janë tri kërkesa, të cilat nuk janë hasur në tenderë të tjerë. Kërkesa e parë është që të dorëzohet certifikatë e konformitetit me standardin PN-EN 62208:2011. Së pari ky standard ka të bëjë me pajisje elektrike të tensionit të ulët dhe montim të pajisjeve të kontrollit dhe çmimet e dhëna për artikuj, vlera totale e punimeve për elektrikë është 35,459 euro apo 13.4% e çmimi të kontratës. Së dyti PN-EN 62208:2011 është standard i shtetit të Polonisë1, dhe sipas rregullave të prokurimit është e ndaluar që të kërkohen standarde të shteteve tjera, përveç të standard europian ose të Kosovës që implementon një standard europian.

[1] PN Certificate
https://www.pkn.pl/en/services/certification/pn-certificate

Kërkesa e dytë është që të dorëzohet certifikatë e kalibrimit të njehsorëve elektrik nga laboratori për energji dhe njehsor të energjisë (Energy & PowerMeter). Edhe kjo kërkese është e panevojshme pasi në dosje të tenderit askund nuk përmenden montimi i njehsorëve. Kërkesa e tretë është që të dorëzohet certifikatë valide e qëndrueshmërisë së performancës CE (EN 40-5:2002), dhe të jetë e bashkangjitur certifikata e karakteristikave të produkteve dhe a-testet e konformitetit, të cilat janë teste që konfirmojnë se produkti është në përputhshmëri me specifikat teknike. Njëjtë si në kërkesën e dytë, as këtu nuk është specifikuar se për cilin produkt është kërkuar certifikata e qëndrueshmërisë. Ky veprim është shkelje e Ligjit të Prokurimit, ku sipas të cilit është e ndaluar që të vendose në kritere, të cilat favorizojnë ndonjë operator ekonomik të caktuar. Veprimi i tillë mund të konsiderohet se përmban elemente të veprës penale për keqpërdorime në prokurimin publik i cili sanksionohet nga neni 415 i Kodit Penal të Kosovës.

Kur tri kërkesave më lartë i shtohet edhe shkurtimi i kohës për të dorëzuar ofertat me arsyen se projekti duhet të përfundojë para përfundimit të vitit fiskal, atëherë përshtatja e kritereve për vetëm një ofertues bëhet edhe më e theksuar. Sipas njoftimit për kontratë, projekti duhet të përfundojë brenda 60 ditëve, ndërsa kontrata është nënshkruar më 21.10.2020. Po të përdorej afati i rregullt për dorëzim të ofertave nënshkrimi i kontratës do të shtyhej edhe për 10 ditë, dhe prapë do të përfundonte brenda vitit fiskal, e për më tepër që publikimi i tenderit mund të bëhej shumë më herët. Shkurtimi i afatit nga 20 ditë, në 10, nuk i ka dhënë kohë të mjaftueshme operatorëve që të mund të pajisen me certifikata të tilla edhe po të dëshironin të merrnin pjesë në tender.

Për shkak që komuna ka përshtatur kriteret për vetëm një ofertues, përmes kritereve të dosjes, shkurtimit të afatit për ofertim ka bërë që çmimi i ofertës të jetë shumë afër vlerës së parashikuar. Po të mos përshtateshin kriteret, do të rritej konkurrenca e si pasojë çmimi i kontratës ka mundur të jetë shumë më i ulët. Por siç duket interesi i komunës nuk ka qenë që të shpenzohen drejtë paratë e taksapaguesve, por të shpërblehet një operator ekonomik me kontratë.

Mësimet

- Autoritetet nuk duhet të paraqesin si kërkesa - certifaka të panevojshme që i përshtaten vetëm një ofertuesi.
- Mungesa e konkurencës dhe sidomos sjell rritje të çmimit dhe rrezikon cilësinë.

Mësimi i nxjerrë nga ky tender është që gjithmonë kur kriteret përshtaten për një kompani të caktuar nuk do të ketë konkurrencë dhe rrjedhimisht do të paguhet çmim më i lartë. Dosjen e tenderit e kanë shkarkuar 50 operatorë ekonomik, mirëpo vetëm një ka ofertuar. Një nga qëllimet e Ligjit të Prokurimit është të arrihet vlera për para, pra që të blihet sa më shumë për sa më pak para, e cila në këtë tender nuk është arritur si rezultat i mungesës së konkurrencës.

Rasti II: Furnizim me llaptop, projektor dhe aparate fotokopjuese për institucione arsimore

Lëshimet

- Hartimi i specifikave të detajuara, që nuk i plotësonte asnjë kompani.
- Komisoni nuk e verfikon normën e TVSh-së.
- Komisioni anashkalon kërkesa.

Në një tender të Komunës së Prishtinës për furnizim me llaptop, projektor dhe aparate fotokopjuese për institucionet arsimore u zgjodh fitues i tenderit një kompani e cila nuk i plotësonte të gjitha specifikat teknike. Komuna kishte hartuar specifika teknike shumë të detajuara që nuk arrinte ti plotësonte asnjë kompani, e ndërsa ishin dorëzuar 12 oferta. Gjatë vlerësimit të ofertave edhe pse kishte anëtarë më përvojë në fushën e IT-së, ata nuk kishin në dijeni rreth procedurave të prokurimit. Të gjithë Operatorët Ekonomik (OE) kishin dhënë normë të TVSH-së të ndryshme, mirëpo këto nuk analizoheshin fare nga komisioni i vlerësimit. Norma të ndryshme të TVSH-së, shkaktojnë edhe dallime në çmim. Dy OE çmimin total e kanë dhënë pa TVSH, e këtë detaj nuk e vërejnë asnjëri nga anëtarët e komisionit. Kjo është një shkelje shumë e rëndë dhe mund të

cilësohet si tentim për të mashtruar Autoritetin Kontraktues (AK), e që është dashur të vërehej nga komisioni i vlerësimit po t'i shikonin me më kujdes tenderët e këtyre dy OE.

Komisioni i vlerësimit vazhdoi pastaj me kontrollimin e specifikave teknike për produktet që kishin ofruar OE, për të shikuar a përputhen me specifikat e kërkuara. Të gjithë OE kishin dërguar katalogje për produktet që i ofronin. Këto katalogje shikoheshin me kujdes nga anëtarët e komisionit që ishin të fushës së IT. Në specifikat për projektor ishte një pikë ku kërkohej që madhësia e imazhit të projektuar të jetë nga 23 deri 300 inç, kërkesë që nuk e plotësonte asnjë OE. Komisioni vendosi që këtë kërkesë mos ta marrë parasysh për të gjithë OE, por këtë e bëri kur ishte duke e shikuar OE me çmimin më të lirë. Komisioni e përmbylli punën, pa verifikuar çmimet për njësi, pa bërë llogaritjen e çmimeve si dhe pa verifikuar normën e TVSH-së. Komisioni i Vlerësimit nuk ka të drejtë që të vlerësojë vetë për të hequr një kërkesë dhe është veprim i paligjshëm, pasi vlerësimi i tenderëve duhet të bëhet në bazë të kërkesave dhe specifikave që janë caktuar më parë. Fitues u zgjedh kompania "Infinit" si OE i përgjegjshëm me çmimin më të lirë, por me dallime në normën e TVSH-së krahasuar me OE tjerë. Infinitt çmimin për projektor e ka dhënë me TVSH 8%, ndërsa shumica OE tjerë e kanë 18%. Kjo nuk është verifikuar nga komisioni i vlerësimit dhe rrjedhimisht, çmimi i këtij produkti është më i lirë te oferta e Infinitt se te ofertat tjera.

Mësimet

- Hartimi i specifikave që gjinden në treg.
- Kujdes në llogaritjen e çmimit duke e pasë parasysh normën e TVSh-së.

Nga ky tender janë nxjerrë shumë mësime lidhur me punën e komisioneve vlerësuese. Komunës i është dorëzuar një raport i monitorimit të punës së Komisionit të Vlerësimit ku është rekomanduar që specifikat teknike të hartohen në përputhje me rekomandimet e Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit (ASHI). ASHI është agjencia që menaxhon shumicën e sistemeve të IT-së për institucionet e Kosovës, e cila përfshihet në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme. ASHI ka hartuar një model të specifikave teknike që autoritet kontraktuese ta përdorin. Në përputhje me dokumentin nga ASHI është rekomanduar specifikat teknike të jenë më gjithëpërfshirëse dhe jo tepër të detajuara në mënyrë që mos të

ketë probleme gjatë vlerësimit të ofertave. Tjetër rekomandim është që komisioni i vlerësimit të ketë parasysh çmimet e sidomos normën e TVSH-së pasi në produkte të IT-së kjo normë ndryshon.

Rasti III: Furnizim lidhur me Digjitalizimin e materialeve moderne, modernizimi i shërbimeve nëpër shkolla si dhe furnizimi me pajisje të shërbimeve online për shkollat e të verbërve

Lëshimet

- Mos hulumtimi i çmimeve të tregut.
- Humbja e të paktën 135 mijë Euro të taksapaguesit.

Ministria e Arsimit në korrik të vitit 2020 shpalli tenderin në vlerë 1.25 milion euro për blerje të tabletëve elektronik dhe disa produkteve tjera. Në tender janë kërkuar të blihen 5000 tabletë me një buxhet prej 1,180,000 euro apo 236 euro për një tablet (1,180,000 / 5000). Në tender ofertuan vetëm dy kompani: Botek SH.P.K. me çmim 823,500 euro, Ilir Kosova SH.P.K. me çmim 820,800 euro dhe Infosoft Systems SH.P.K. & FutureBITS SH.P.K. me çmim 1,139,400 euro. Dy kompanitë e para janë eliminuar dhe në vendimin e fundit autoriteti kontraktues ka rekomanduar që fitues i kontratës të jetë konsorciumi Infosoft Systems shpk & FutureBITS SH.P.K. me çmim 1,139,400 euro. Kompanitë e eliminuar nuk kanë ofertuar tabletë sipas specifikave teknike të kërkuara. Kompania e rekomanduar ka ofertuar me modelin e tabletit Lenovo Tab M10 FHD Plus dhe çmim 227 euro. Ky tablet në Kosovë në Gjirafa50 shitet 208 euro, apo 19 euro më pak se çmimi i dhënë. Kur të merret parasysh se çmimi në Gjirafa50 është çmim i pakicës atëherë dallimi do të jetë edhe më i madh pasi për një sasi prej 5000 tabletave jepet çmimi i shumicës. Ky produkt edhe nëse importohet del më lirë se çmimi i ofertuar. Në Austri dhe Gjermani i njëjti tablet ka pasur çmim 175 euro në kohën kur është publikuar tenderi (korrik 2020). Në Maqedoni një dyqan këtë tablet e shet për 217 euro. Të gjitha këto çmime janë çmime të shitjes me pakicë, e kur të merret parasysh që Ministria dëshiron të blejë 5000 tabletë atëherë me siguri që çmimi i shumicës do të ishte edhe më i ulët. Dallimi në çmim nga çmimi i tregut me atë të dhënë nga kompania e rekomanduar për të fituar tenderin është 10

deri 52 euro, me një dallim mesatar prej rreth 27 euro. Dallimi në çmim do të ishte 135,000 euro (27*5000).

Mësimet

- Hulumtimi i çmimeve të tregut është obligim ligjor dhe i nevojshëm.
- Autoriteti Kontraktues duhet të parashikoj sipas ligjit, shpenzimin e parasë së taksapaguesit.

Mundësia për të ofertuar me çmime më të larta të tregut ka ardhur si rezultat që Ministria e Arsimit nuk e ka parashikuar saktë buxhetin për tabletë. Kjo ka mundur të bëhet me qëllim apo pa qëllim. Mirëpo Ministria është e obliguar sipas Ligjit të Prokurimit Publik që gjatë përcaktimit të vlerës së parashikuar të ketë parasysh çmimin e tregut. Pra duhet të bëhet një hulumtim i tregut, të analizohen çmimet në treg, në mënyrë që të arrihet sa më shumë vlera për para. Ministria ka mundur të parashikonte që një tablet me specifikat e kërkuar në treg kushton 200 euro e prapë çmimi i parashikuar të jetë brenda çmimit të tregut. Parashikimi jo i saktë dhe i fryrë mund të shkaktojë që të paguhet më shtrenjtë se çmimi i tregut, i cili në këtë rast si duket do të ndodhë. Nga llogaritja e bërë më lartë vërehet se një gabim në përcaktim të vlerës së parashikuar mund të bëjë që buxhetit të Kosovës ti humben 135,000 euro.

ORCA

Prishtinë, maj 2020